

REPUBLICA E KOSOVËS/REPUBLIKA
KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KOMUNALE NË MITROVICE/ OPŠTINSKI SUD
U MITROVICU/ MUNICIPAL COURT IN MITROVICA



C.nr.64/12

GJYKATA KOMUNALE NË MITROVICË, (e vendosur ne objektin e Gjykatës Komunale në Vushtrri), e përbërë nga gjyqtari individual **Faton Ademi**, me proçesmbajtësen Elheme Peci në çështjen juridike të paditësit: _____ nga _____, kundër të paditurës: Komuna e _____ - Drejtoria për Arsim të cilën e përfaqëson avokati publik komunal: _____, baza e kontestit: Kontest Pune, pas mbajtjes së seancës kryesore të datës: 14.11.2012 me datën 26.11.2012 bie këtë:

A K T G J Y K I M

- **ANULOHEN:** Vendimi i Komisionit për Ankesa dhe Parashtresa i DKA-së i datës : 01.03.2012 si dhe Vendimi i Drejtitorit të Drejtorisë Komunale të Arsimit në _____ mbi ndërprerjen e kontratës së punës i datës: 24.01.2012 si të **KUNDËRLIGJSHME**
- **OBLIGOHET** e Paditura- Drejtoria Komunale e Arsimit në _____ që brenda afatit 7 ditor ta kthej paditësin në punë në pozitën e njëjtë apo ta sistemoj të njëtin në ndonjë vend tjetër të ngjashëm që i përgjigjet kualifikimeve dhe aftësive profesionale
- **OBLIGOHET** e Paditura që paditësit në emër të kompensimit të pagave t'ia paguajë shumën prej 3636.98 euro, duke llogaritur siç vijon: për muajt Shtator – Dhjetor 2011 t'ia paguajë diferençën e pa paguar për 4 orë mësimi që gjithsej është 286.34 euro, ndërsa për vitin 2012 shumën prej 3350.64 euro, në total shumën prej 3636.98 euro
- **OBLIGOHET** e Paditura që t'ia paguaj paditësit në emër të shpenzimeve procedurale shumën prej 50 euro në emër të shpenzimeve për ekspertizë financiare, ndërsa gjykatës në emër të përpilimit të aktgjykimit shumën prej 25 euro të gjitha këto në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm,

A r s y e t i m

Paditësi me datë 29.03.2012 ka parashtruar në gjykatë padi me anë të së cilës ka kërkuar anulimin e vendimive të Drejtorisë Komunale të Arsimit në _____ si palë e paditur me të cilat i është ndërprerë marrfëdhënja e punës, si dhe ka kërkuar pagesën e të gjitha pagave që nga koha kur është larguar nga puna, pagesën që e paditura i ka mbetur bërxh për muajt shtator 2011 / dhjetor 2011 për 4 orë mësimore në muaj si dhe kompensimet e procedurës kontestimore.

Gjykata me datë 26.09.2012 ka mbajtur seancën përgatitore, ndërsa në këtë seancë paditësi i ka dëkluar se mbetet në tërësi pranë padisë dhe kërkesëpadisë, i kontestoi vëndimiet e të paditurës si të kundërligjshme, sepse nuk janë respektuar dhe përfillur dispozitat ligjore të Ligjit të Punës si Ligj material në këtë çështje, me rastin e ndërprerjes së marrëdhënies së punës.

E paditura përmes përfaqësuesit të saj në këtë seancë deklaroi se e kundërshton në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë duke theksuar se pa marrë parasysh të metat e lëshimit eventual të akteve lidhur me procedimin e rastit konsideroi se ndërprerja e marrëdhënies së punës është bërë konform ligjit, për arsyen se kjo ndërprerje është bërë sipas fuqisë ligjore.

Qëndrimet e palëve në këtë procedurë edhe në dy seancat kryesore që janë mbajtishin të njëjtë së, përderisa paditësi insistonte se është shkel ligji nuk është respektuar afati i paralajmërimit para ndërprerjes së marrëdhënies së punës, se nuk është e vërtet se kjo ndërprerje është bërë sipas fuqisë ligjore, ndërsa përfaqësuesi i të paditurës shkurtimisht deklaroi se qëndron në tërësi sipas thënieve nga seanca e kaluar.

Paditësi propozoi që të caktohet një ekspert financiar për të bërë përllogaritjet e shumave që i kérkon paditësi në padi.

Në fjalën përfundimtare paditësi mbronte qëndrimin e tij se e paditura ka shkel ligjin dhe kerkoi nga gjykata që padinë dhe kërkesëpadinë ta aprovoj si të bazuar, përderisa përfaqësuesi i të paditurës mbeti në tërësi sipas thënieve nga seancat e kaluara.

Gjykata në procedurën e Provave administroi këto prova: Vendimin e Komisionit për Ankesa dhe Parashtresa i të Paditurës i datës: 01.03.2012, vendimin e drejtorit të drejtorisë komunale të arsimit në i datës 24.01.2012, ekspertizën financiare të ekspertit , qarkullimin për llogari në emër të paditësit, vërtetimi i shkollës së mesme të lartë teknike: " " në i datës 05.11.2012, vendimin e vitit 1997 nga këshilli i shkollës, certifikatën lëshuar GTZ mbi trajnimin Didaktika Profesionale datës: 27 qershor 2008, certifikatën lëshuar nga GTZ Didaktika dhe Metodika i datës: 07 korrik 2006, mirënjojje lëshuar nga shkolla ku punonte paditësi i datës: 07.03.2011, kontratën e punës 01.09.2011- 31.08. 2012

Gjykata të gjitha provat i vlerësoi një nga një dhe në raport me njëra tjetrën në përputhje me nenin 7 dhe 8 të LPK-së dhe arriti deri në këto konkludime që do të paraqiten më poshtë.

Nga Kontrata e Punës e lidhur me datë 01.09.2011- deri me 31.08.2012 vërtetohet se paditësi me të paditurën kanë pas një kontratë pune, pra ka qenë në marëdhënie pune dhe se ndërprerja është bërë para skadimit të kësaj kontrate.

Vendimi mbi ndërprerjen e kontratës së punës nxjerr nga e paditura është bërë me datë: 24.01.2012. E paditura nuk ofroi prova se paditësin e ka paralajmëruar se do t'ia ndërpresë mërrëdhënien e punës ashtu siq e obligon Ligji i Punës e më konkretisht nenj 71 i këtij ligji, ndërsa ka qenë e obliguar që 60 ditë më herët ta paralajëmroi paditësin pasi paditësi ka pas më shumë se 10 vite përvjose pune, ndërsa vetëm një rast është kur punëdhësni ka mundësi që t'ia ndërpresë mërrëdhënien e punës të punësaurit pa e paralajmëruar nëse: i punësuari është sjell keq, dhe e cila sjellje ka qenë e rregulluar me aktet e brendshme të të paditurës gjë që në rastin konkret ka munguar.

Në arsyetimin e paditëses në vendimin e parë shkruan se paditësja vendimin e mbështet në nenin 70 pika 1.1 dhe 1.3 të Ligjit të Punës.

Pika 1.1 e nenit 70 të Ligji të Punës thotë se punëdhënësi mundet t'ia ndërpresë kontratën e punës të punësuarit kur ndërprerja e tillë është bërë për arsyen ekonomike, teknike apo organizative, ndërsa pika 1.3 thotë se kontrata e punës nga ana e punëdhënësit ndërpitet nëse është e papërshtatshme për punëdhënësin që të punësuarin ta transferoi në një vend tjeter të punës, ta trajnojë a ta kualifikojë atë për të kryer punën ose ndonjë punë tjeter.

Paditësja në vendimini e saj i është referuar këtij nenit e më konkretisht paragrafit 1.1 por në asnjë rast nuk e ka arsyetuar atë se cila është natyra ekonomike: mungesa e buxhetit apo cila, cila është natyra teknike apo ajo organizative.

Kjo situatë më së miri sqarohet në nenin 76 të Ligjit të Punës ku përfshihen largimet kolektive që përfshijnë së paku 10% të të punësuarve, ndërsa në rastin konkretnë ka qenë largim individual apo ndërprerje e marrëdhënies së punës vetëm një individ.

Ndërsa në paragrafin 1.3 të nenit 70 e paditura nuk ka treguar asnjë gatishmëri që paditësin ta transferoj në ndonjë vend tjeter që i përgjigjet kualifikimit të tij profesional, por vetëm kalimthi e përmend e paditura në vendimin e shkallës së dytë apo përgjigjen në ankesë, ndërsa sa i përket trajnimeve disa nga ato trajnime paditësi i ka mbajt dhe përkëto ofron prova (certifikata) se kë marrë pjesë e që luajnë rol të rëndësishëm në mësimdhënie dhe se nuk ka hezituar që të ndjek edhe trajnime tjera që do t'i ofronte e paditura.

E paditura në asnjërin vendim dhe me asnje rrethanë neriet e lartë përmendura nuk i ka respektuar dhe gabimisht i ka zbatuar, sepse nuk posedon prova me të cilat do të mund të vërtettonin se paditësit i është ndërprerë kontrata e punës për ato shkaqe, pasi e paditura ka pas mundësi të transferimit në ndonjë vend tjetër të punës, pasi paditësi është me profesion jurist, ndërsa gamia e punëve apo pozitave që mund të jenë të përshtatshme për një jurist është shumë e madhe në të gjitha sistemet e lëre më atë arsimor, pastaj i punësuari ka qenë edhe i trajnuar dhe i certifikuar.


Përfaqësuesi i të paditurës në seancë ka deklaruar se ndërprerja e marrëdhënies së punës është bërë sipas fuqisë ligjore, gjë që nuk është e vërtetë sepse në nenin 67 të Ligjit të Punës janë të numëruara në mënyrë laksative rastet kur ndërprerja e marrëdhënies së punës bëhet sipas fuqisë ligjore, gjë që në rastin konkret ka munguar.

Ndërsa në lidhje me pikën IV të dispozitivit gjykata e mori për bazë shpenzimet që paditësi i ka deponuar paraprakisht për ekspertizë financiare, si dhe shpenzimet gjyqësore përpilimin e aktgjykit.

Vendimin mbi shpenzimet procedurale e mori në bazë të nenit 452 të LPK-së dhe atësiq vijon: për ekspertizë financiare shumën prej 50 euro, ndërsa për aktgjykim shumën prej 25 euro.

Andaj, gjykata konform nenit 143, nenit 476 të LPK-së vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA KOMUNALE NË MITROVICE,
C.nr. 64/2012 me dt. 26.11.2012**



UDHËZIM PËR MJETIN JURIDIK under këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 7 ditësh, Gjykatës se Qytetit të Mitrovicës nëpërmjet kësaj gjykate.